



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.565 Akti

Nr.572 Vendimi

Tiranë, më 14.10.2022

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Roland Ilia</b>	<b>Relator</b>
<b>Etleda Çiftja</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 12.10.2022, ora 10:00', në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Erjon Imeraj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

**Ligji nr. 44/2015**, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";

**Ligji nr. 49/2015**, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Roland Ilia, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Erjon Imeraj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*. Subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj u shortua si subjekt me shortin e hedhur më 15.6.2020 në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Trupi gjykues, i shortuar për të shqyrtuar çështjen, përbëhet nga komisionerët, Alma Faskaj, me cilësinë e relatores, Suela Zhegu dhe Etleda Çiftja, anëtare të tij. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 22.6.2020<sup>1</sup> u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues për të cilin deklaroi me *e-mail* në datën 7.12.2020 mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Marie Tuma.

3. Trupi gjykues, në vijim, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI)<sup>2</sup>, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK)<sup>3</sup> dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë<sup>4</sup>.

<sup>1</sup>Vendimi i ndërmjetëm nr. 1, datë 22.6.2020.

<sup>2</sup>ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar<sup>1</sup>, duke konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të tremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave;

<sup>3</sup>DSIK-ja ka përcjellë një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2021, të KDZH-së.

<sup>4</sup>Këshilli i Lartë i Prokurorisë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2021, përcjell në Komision raportin për vlerësimin e aftësisë aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit dhe aktet bashkëlidhur tij.

5. Komisioni, me vendimin<sup>5</sup> e datës 13.7.2022, për shkak të largimit për një afat të pacaktuar të komisioneres Alma Faskaj, për arsye objektive, ka vendosur me short zëvendësimin e saj me komisionerin Roland Ilia, në cilësinë e relatorit të çështjes, i cili në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit. Subjekti, pasi u njoh me vendimin e Komisionit datë 13.7.2022 për zëvendësimin e relatorit së çështjes, deklaroi se nuk ka konflikt interesi.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes Roland Ilia, i cili shprehu se nuk kishte hapa hetimorë të tjerë për të ndërmarrë, me vendimin datë 27.9.2022, vendosi të mbyllë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Erjon Imeraj bazuar në tria kriteret e vlerësimit, njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative dhe të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të drejtën për të paraqitur shpjegime/prova shtesë, brenda datës 10.10.2022.

7. Për një proces të rregullt ligjor subjektit të rivlerësimit Erjon Imeraj i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; njoftimi mbi përbërjen e trupit gjykues dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke iu kërkuar shpjegime mbi rezultatet e hetimit.

8. Subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj tërhoqi dokumentacionin me dosjen e hetimit në datën 4.10.2022 dhe dërgoi me *e-mail* prapësimet mbi rezultatet e hetimit në datën 10.10.2022 dhe lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni.

9. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 10.10.2022.

10. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 12.10.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma. Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

11. Subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve". Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z. Erjon Imeraj ka qenë bashkëpunues, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

---

<sup>5</sup>Vendim i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 13.7.2022.

### III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

**12.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**13.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**14.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës<sup>6</sup>.

**15.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* dhe raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI dhe deklaratat periodike të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**16.** Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Erjon Imeraj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

---

<sup>6</sup>Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## A. RIVLERËSIMI I PASURISË

17. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, mundësitë për fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit.

Subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj në deklaratën e pasurisë *Vetting* të datës 27.1.2017 ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

**18. Automjet tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2001, me targa \*\*\*, blerë në vitin 2010 me të ardhura nga puna ndër vite. Vlera: 700.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*<sup>7</sup> dokumentacionin e fitimit të kësaj pasurie dhe praktikën e regjistrimit të saj në DPSHTRR.

Deklarimet e subjektit: subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë automjetin në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës: “Automjet tip ‘Mercedes-Benz 270’, viti 2002, blerë në vitin 2010 nga kursimet në vlerën 700.000 lekë”. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* subjekti ka deklaruar se për blerjen e automjetit sa më sipër kanë shërbyer “të ardhura nga puna në vite”.

Referuar deklarimeve të subjektit për burimin e krijimit të pasurisë, Komisioni konstaton pasaktësi në burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2012 me deklaratën *Vetting*.

### Hetimi i kryer dhe verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri

18.1 Në vijim të hetimit, DPSHTRR-ja<sup>8</sup> informon dhe përcjell në Komision praktikën e regjistrimit të automjetit tip “Mercedes-Benz”, vit prodhim 2001, targa \*\*\*. Për automjetin me targa \*\*\*, referuar dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja, rezulton se:

- Me kontratë shitje nr. \*\*\*, në datën 18.1.2010, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi V.A në vlerën 700.000 lekë automjetin tip “Mercedes-Benz E 270 CDI”, vit prodhimi 2001, lënda djegëse naftë, ngjyrë gri, me targa \*\*\*, nr. shasie \*\*\*. Subjekti, pas blerjes, i ka ndryshuar targën automjetit nga \*\*\* në \*\*\*. Aktualisht, automjeti mban targën \*\*\*. Sipas deklaratës doganore të datës 17.9.2009, automjeti rezulton të jetë importuar nga shteti italian<sup>9</sup> në vlerën 6.000 euro + 203.789 lekë zhdoganimi. Përcillet me dokumentacionin nga DPSHTRR-ja kontrata e shitjes nr.\*\*\*, datë 28.12.2018, me të cilën subjekti i rivlerësimit i shet automjetin me targa \*\*\* shtetasit O.RR, në vlerën 550.000 lekë.

<sup>7</sup>Shihni aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së, në të cilën bashkëlidhet kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 18.01.2010, shitës V.A blerës subjekti i rivlerësimit. Objekti i kontratës automjeti “Daimler Chrysler” nr. shasie \*\*\*, me targa \*\*\*, në vlerë 700.000 lekë. Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2017, të DPSHTRR-së, konfirmon automjetin me targa \*\*\*, në emër të z. Erjon Imeraj.

<sup>8</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2020, e DPSHTRR-së.

<sup>9</sup>Me dokumentacionin e DPSHTRR-së përcillet akti notarial nr. \*\*\*, datë 18.9.2009, kontratë shitje automjeti me të cilën shtetasi A.L i shet shtetasit V.A mjetin “Daimlerchrysler”, vit prodhimi 2001, me nr. shasie \*\*\*, në vlerën 6.000 euro.

- Sipas AMF-së *online* rezulton se për automjetin janë prerë policat e sigurimit dhe subjekti i rivlerësimit rezulton pronar dhe përdorues prej vitit 2010 dhe ka prerë policën e fundit të sigurimit në datën 9.2.2017 me periudhë të mbulimit në sigurim deri në datën 12.2.2018.

**18.2** Në analizë të dokumentacionit sa më sipër, konstatohet nga Komisioni se vlera e blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit është më e ulët sesa vlera e zhdoganimit të tij nga ana e shitësit të automjetit, 700.000 lekë kundrejt 1.026.809 lekë ekuivalenti i shumave 6.000 euro + 203.789 lekë.

**18.3** Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën *Vetting* si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhura nga puna ndër vite. Ai i bashkëlidh deklaratës *Vetting*<sup>10</sup> dokumentacionin e marrëdhënies së tij të punësimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Rrethit Tiranë<sup>11</sup>, ndërsa “Raiffeisen Bank”<sup>12</sup> sh. a. përcjell në Komision lëvizje llogarie nr. \*\*\* në emër të subjektit të rivlerësimit, ku prej datës 13.5.2005 transferohen pagat e tij nga Prokuroria e Përgjithshme.

**18.4** Sa më lart, Komisioni hartoi analizën financiare për mundësinë e blerjes së automjetit me burimin e deklaruar prej tij. Rezultoi nga analiza financiare se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të blejë automjetin me të ardhura nga paga e tij ndër vite.

**18.5** Në përfundim të verifikimeve për këtë pasuri rezultoi nga hetimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vitin 2010, në vlerën 700.000 lekë. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se çmimi i blerjes së automjetit prej 700.000 lekësh rezulton më i vogël sesa vlera e zhdoganuar prej shitësit të automjetit 6.000 euro + 203.789 lekë. Komisioni, mbi konstatimin sa më sipër, i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit**

**18.6** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se: *“Sa i përket vlerës së blerjes plus asaj të zhdoganimit nga ana e shitësit, 6.000 euro + 203.789 lekë, për këtë fakt vihem në dijeni vetëm nga aktet e hetimit administrativ të kryer nga ana e KPK-së. Nuk kam pasur dijeni dhe as kam pyetur se cili ka qenë çmimi i blerjes së automjetit nga ana e shtetasit V. A. Sqaroj se përpara se të realizohej blerja nga ana ime, ishte ofruar për shitje në vlerën 800.000 lekë, çmim ky i përcaktuar paraprakisht nga shitësi. Pasi kam parë gjendjen teknike të automjetit dhe e kam provuar atë, është dakordësuar çmimi 700.000 lekë, i cili është pranuar me vështirësi nga shitësi dhe është ai i pasqyruar rregullisht në kontratën noteriale të shitjes dhe çmimi real i transaksionit. Me këtë shtetas nuk kam asnjë lloj njohjeje, si dhe nuk kam pasur as përpara dhe as pas realizimit të shitjes së automjetit kontakte të asnjë lloji. Nga ana tjetër, blerja e këtij automjeti nga ana ime është bërë tërësisht me burime të ligjshme, pasi rezulton e provuar edhe nga hetimi i Komisionit, që të ardhurat e mia dhe mundësia e kursimit në datën e blerjes së automjetit ka qenë në shumën 1.809.981 lekë, si dhe është realizuar përpara emërimit tim si prokuror, çka duhet të përforcojë*

<sup>10</sup>Aneks \*\*\* ILDKPKI.

<sup>11</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016, të Prokurorisë së Përgjithshme me të cilin vërtetohet se Erjon Imeraj në detyrë oficer i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme për periudhën 1.5.2005 – 5.6.2012.

<sup>12</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2020.

*më tepër bindjen te Komisioni, që diferenca në çmimin e automjetit për të cilin më është kërkuar të japë shpjegime, nuk mund të përbëjë as indicie për të ngritur dyshime se mund të jetë bërë për të më favorizuar mua si subjekt apo se kontrata e shitblerjes së automjetit mund të mos paraqesë çmimin real të blerjes së këtij automjeti”.*

### **Qëndrimi i subjektit në seancë dëgjimore**

**18.7** Subjekti i rivlerësimit, mbi çmimin e blerjes së automjetit prej 700.000 lekësh, rezulton më i vogël sesa vlera e zhdoganuar prej shitësit të automjetit 6.000 euro + 203 789 lekë, mbajti të njëjtin qëndrim në seancë dëgjimore dhe dha të njëjtat shpjegime me ato të hetimit.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**18.8** Nga hetimi i Komisionit rezultoi se pasuria është krijuar para marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit në qershor të vitit 2012 dhe është shitur në vitin 2018 pas plotësimit të deklaratës *Vetting*. Në kuptim të nenit 1, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*. Në zbatim të parashikimit kushtetues të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, organet e rivlerësimit kanë detyrimin të shqyrtojnë deklaratat e subjektit për të shkuarën e tij dhe sigurisht të përcaktojnë vlerën e tyre provuese në raport e harmoni me të gjitha rrethanat e faktit që rezultojnë nga burime të tjera. Në këtë këndvështrim, shpjegimet e subjektit të dhëna për pasuritë e krijuara para detyrës në funksion të sqarimit të çështjeve të rezultuara nga hetimi konsiderohen shpjegime që japin informacion relevant për pasurinë objekt rivlerësimi. Mbi të gjitha, krijimi i saj i provuar jashtë kontekstit të procesit të rivlerësimit dhe në mungesë edhe teorike, jo vetëm praktike, të qëllimit të subjektit për të deformuar veprimtarinë hetimore për vlerësimin e pasurisë sipas këtij procesi, u japin shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit gjatë hetimit në kohezion me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, vlerën e nevojshëm për t’u përdorur në analizën që trupi gjykues kreu për pasurinë objekt rivlerësimi.

Trupi gjykues i Komisionit në përfundim, pas vlerësimit çmon se problematika e konstatuar mes diferencës së çmimit të blerjes nga subjekti me çmimin e blerjes nga shitësi në vlerën relative për të cilën bëhet fjalë nuk është e tillë që të vlerësohet si shkak penalizues administrativisht në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

Në analizë të shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit, në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues çmoi se deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe nuk u konstatuan problematika në këndvështrim të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”*. Subjekti ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

**19. Llogari rrjedhëse pranë “Credins Bank”, ku derdhet paga, gjendja 523.000 lekë. Pjesa takuese: 100%**

Deklarimet e subjektit: në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës së vitit 2012 subjekti ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse ‘Credins Bank’, krijuar për efekt page 50.000 lekë, pjesa takuese 100 %. Në DIPP-të e viteve 2012 – 2016, subjekti për llogarinë e pagës në “Credins Bank” ka deklaruar vlerat 351.846 lekë, 351.846 lekë, 466.340 lekë dhe 472.422 lekë.

### **Hetimi i kryer dhe verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri**

**19.1** “Credins Bank”<sup>13</sup> informon Komisionin se subjekti i rivlerësimit është klient i kësaj banke dhe ka llogari rrjedhëse page të hapur në datën 5.1.2010 me nr. \*\*\*. Bashkëlidhet me përgjigjen lëvizje llogarie në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje në datën 31.12.2016 në shumën 472.422 lekë. Konstatohet se në datën 30.1.2017 gjendja e llogarisë së pagës korrespondon me vlerën prej 523.000 lekësh të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

Në përfundim dhe në analizë të deklarimeve dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se nuk rezultuan problematika lidhur me procesin e rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri.

### **20. Llogari bankare “\*\*\*” pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të djalit D.I, e mbyllur për 18 vjet, krijuar nga kursimet dhe dhuratat për ditëlindjen e djalit. Vlera: 336.549 lekë.**

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* nxjerrje llogarie të datës 18.10.2016 pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të shtetasit D.I për periudhën 19.7.2013 – 18.10.2016, me gjendje në vlerën 336.549 lekë.

Deklarimet e subjektit: Subjekti i rivlerësimit në DIPP-të periodike për vitet 2013 – 2016 lidhur me këtë pasuri ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 llogari bankare \*\*\* pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të djalit D.I, e mbyllur për 18 vjet, krijuar nga kursimet dhe dhuratat për lindjen e djalit. Vlera 100.000 lekë dhe në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar llogari bankare \*\*\* pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të djalit D.I, e mbyllur për 18 vjet, krijuar nga kursimet dhe dhuratat për lindjen e djalit. Vlera: 200.575 lekë.

Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar llogarinë e kursimit pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në DIPP-të e vitit 2015-2016.

### **Hetimi i kryer dhe verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri**

**20.1** “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>14</sup> informon Komisionin se shtetasi D.I ka llogari kursimi me kod klienti \*\*\*, e hapur më 19.7.2013 nga derdhja *cash* e subjektit të rivlerësimit Erjon Imeraj, me vlerë 100.000 lekë, ndërsa gjendja e saj në datën 31.12.2016 është 336.549 lekë<sup>15</sup>. Vlera e llogarisë së kursimit, prej datës së hapjes është rritur nga derdhjet e realizuara, të cilat në mënyrë të përmbledhur nga totali i derdhjeve në periudhën 19.7.2013 – 13.3.2015 është në vlerën 320.575 lekë.

<sup>13</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020.

<sup>14</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2020.

<sup>15</sup>Gjendja në datën 1.12.2020 e kthim përgjigjes nga “Intesa Sanpaolo Bank” është 412.644 lekë.



**20.2** Subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* dhe gjatë hetimit se si burim i krijimit të vlerës së llogarisë së kursimit janë kursimet dhe dhuratat për ditëlindjen e djalit. Komisioni, në analizën financiare të kryer, si burim të krijimit të saj ka konsideruar vetëm kursimet e subjektit dhe bashkëshortes së tij. Ndërsa deklarimi i subjektit se si burim krijimi kanë qenë edhe dhuratat për ditëlindjen e djalit nuk është përfshirë në analizën financiare pasi nuk u arrit të provohej me dokumentacion, përveç derdhjes *cash* në datën 31.7.2014 nga shtetasja D.I.

Në përfundim dhe në analizë të deklarimeve dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se nuk rezultuan problematika lidhur me procesin e rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri.

**21. Apartament në rrugën “\*\*\*\*” p. \*\*\*, Tiranë**, për të cilin subjekti, në seksionin “të dhëna konfidenciale” në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar se banon dhe është në pronësi të xhaxhait S.I, lënë në përdorim pa afat dhe pa shpërblim.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* deklaratën noteriale<sup>16</sup> nr. \*\*\*, datë 26.1.2017, me deklarues shtetasin S.I i cili deklaron<sup>17</sup>: “... se kam në pronësinë time një apartament banimi me adresë në qytetin e Tiranës, Rr. ‘\*\*\*\*’, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, i cili figuron i regjistruar në ZVRPP Tiranë me numër pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z.k. \*\*\*, bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë në datën 6.1.2014 ... këtë apartament banimi prej vitit 2014 ia kam dhënë në përdorim të përkohshëm nipit tim të quajtur Erion Imeraj për të banuar familjarisht, pasi ai nuk kishte banesë në pronësi të tij”.

**21.1** Komisioni, sa më sipër, hetoi mbi deklaratimet e subjektit për adresën sipas gjendjes civile dhe adresës ku banon në DIPP-të periodike nga vitet 2012 – 2016 dhe nga hetimi rezultoi se:

Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si adresë, në të cilën është e regjistruar në Gjendjen Civile, “rruga ‘\*\*\*\*’, pallati \*\*\*, Njësia nr.\*\*\* Tiranë” dhe adresë të vendqëndrimit “rruga ‘\*\*\*\*’, pallati \*\*\*, Njësia nr. \*\*\* Tiranë”. Subjekti i bashkëlidh deklaratës *Vetting* deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 26.1.2017, në të cilën xhaxhai i subjektit ka deklaruar se subjekti banon në banesën në pronësi të tij që nga viti 2014. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës së vitit 2012, subjekti ka deklaruar adresë sipas gjendjes civile “rruga ‘\*\*\*\*’, pallati \*\*\*, Njësia nr. \*\*\* Tiranë”.

**21.1.1** Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti nuk ka deklaruar adresë sipas gjendjes civile dhe as adresë tjetër banimi, ndërsa në DIPP-në e vitit 2013 subjekti deklaron adresë tjetër banimi “rruga ‘\*\*\*\*’”.

Subjekti, i pyetur<sup>18</sup> nga Komisioni gjatë hetimit se në cila banesa ka banuar që nga momenti që ka marrë detyrën për herë të parë, përgjigjet: “... në momentin e marrjes së detyrës, adresë banimi kam pasur adresën rruga ‘\*\*\*\*’ Nr. \*\*\*, Tiranë. Kjo është

<sup>16</sup>Shihni aneksin \*\*\* ILDKPKI.

<sup>17</sup>Bashkëlidhet me deklaratën certifikatë për vërtetim pronësie lëshuar në datën 6.1.2014 për pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, apartament me sip. 112.90 m<sup>2</sup>.

<sup>18</sup>Pyetësor nr. 1, përgjigjja 1, 2, 3.

*banesa e prindërve të mi. Prej fundit të vitit 2012, pas martesës, banoj në apartament në rrugën ‘\*\*\*’, pallati \*\*\*, hyrja \*\*\* Tiranë, në pronësi të xhaxhait tim S.I, lënë në përdorim pa shpërblim”. Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve deklaraten noteriale nr. \*\*\*, datë 4.12.2020, të shtetasit S.I, i cili ka deklaruar se: “Në deklaratën noteriale<sup>19</sup> nr. \*\*\*, datë 26.1.2017, është bërë një gabim material në hartimin e saj pasi apartamentin pronë e imja ia ka kam dhënë në përdorim nipit tim Erjon Imeraj jo në vitin 2014, por në vitin 2012”.*

**21.1.2** Mbi adresat e banimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile<sup>20</sup>, e cila informon se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij figurojnë të regjistruar në Njësinë Administrative nr. \*\*\*, Bashkia Tiranë, në rrugën “\*\*\*”.

Në analizë të deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit e provave të administruara gjatë hetimit mbi adresat e banimit, trupi gjykues vlerësoi se pavarësisht adresave të ndryshme të deklaruara, kryesisht emrat e rrugëve, rezultoi e provuar se ndryshimet kanë të bëjnë me ndryshimin e adresarit të qytetit<sup>21</sup> dhe nuk dhanë *indicie* për pasuri tjetër të përdorur nga subjekti i rivlerësimit.

**21.2** Në gjendjen faktike të çështjes objekt vlerësimi marrëdhënia e përdorimit të apartamentit të xhaxhait nga subjekti i rivlerësimit përfshihet te marrëdhënia e huapërdorjes për shkak të qëndrueshmërisë së saj si marrëdhënie nga viti 2012 e në vijim, qetësisht, pa ndërprerje nga subjekti i rivlerësimit. Në analizë të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se: “14. *Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose Komisionerin Publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. 4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”, sipas të cilit shtetasi S.I konsiderohet person tjetër i lidhur. Përveç sa më lart, Komisioni, për të hequr çdo dyshim të mundshëm të arsyeshëm hetoi mbi këtë pasuri në përdorim nga subjekti i rivlerësimit.*

### **Hetimi i kryer dhe verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri**

**21.3** Në vijim të hetimit për pasurinë objekt rivlerësimi, Komisioni iu drejtua shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.<sup>22</sup> për dokumentacion dhe informacion mbi pagesat e kryera për këto pasuri. \*\*\* sh.p.k. informon dhe përcjell në Komision dokumentacionin e blerjes së dy pasurive apartament dhe garazh, të deklaruara në përdorim nga subjekti i rivlerësimit.

Sipas dokumentacionit bashkëlidhur rezulton se në datën 10.3.2010 është lidhur kontratë për premtim shitje jo përpara noterit, ndërmjet shtetasit S.I dhe shoqërisë \*\*\* me objekt të kontratës apartament me sipërfaqe shfrytëzimi 112.9 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe

<sup>19</sup>Shihni aneksin \*\*\* ILDKPKI.

<sup>20</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

<sup>21</sup>Nga konsultimi i Komisionit në faqen www.vendime.al, Këshilli Bashkiak Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.2.2014, ka vendosur të miratojë emërtimin e një prej rrugëve të qytetit të Tiranës, me emërtimin “\*\*\*” të rrugës që lidh \*\*\* deri te \*\*\*.

shërbimi me sipërfaqe 18.4 m<sup>2</sup>, vlera 110.000 euro dhe vendparkimi me sipërfaqe 17.82 m<sup>2</sup>, vlera 10.000 euro. Me kontratë shitje për pasuri të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 5.12.2013, midis shtetasit S.I blerës dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. shitës janë shitur pasuritë nr. \*\*\*, ZK\*\*\*, vol \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 112.9 m<sup>2</sup>, sipërfaqe shërbimesh 18.4 m<sup>2</sup>, me adresë rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, apartamenti \*\*\*, në vlerën 110.000 euro dhe pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol \*\*\*, f. \*\*\*, me sipërfaqe 17.82 m<sup>2</sup> garazh në vlerën 10.000 euro. Bashkëlidhen me përgjigjen kopje të mandatarëtimeve për pagesat e kryera dhe rezultojnë se shtetasi S.I në periudhën 9.3.2010 – 26.6.2013 ka arkëtuar në favor të shoqërisë \*\*\* sh.p.k. për pasuritë sa më sipër vlerën në total 114.800 euro + 707.000 lekë.

Shoqëria \*\*\* sh.p.k. bën me dije, gjithashtu, lidhur me marrëdhënien me shtetasin S.I se ai nuk ishte një klient rastësor prandaj është aplikuar një çmim preferencial nga shoqëria. Me z. S.I, \*\*\* në profesion, si shoqëri ndërtimi kanë pasur disa bashkëpunime ndër vite për disa nga projektet e ndërtimit të shoqërisë<sup>23</sup>. Në kuadër të të gjitha bashkëpunimeve dhe të marrëdhënieve të krijuara me z. S.I vjen edhe trajtimi me çmimin preferencial në ndryshim me trajtimin e një klienti të zakonshëm.

Në kërkesën drejtuar shoqërisë \*\*\*<sup>24</sup> sh.p.k., Komisioni i kërkoi informacion kësaj shoqërie nëse shtetasit Erjon, M, D, B, D Imeraj kanë kontrata për tjetërsim pasurish të paluajtshme me këtë shoqëri edhe në objekte të tjera të ndërtuara nga shoqëria dhe informohet se asnjë nga shtetasit e sipërpërmendur nuk ka marrëdhënie tjetërsimi pasurie të paluajtshme me shoqërinë \*\*\* sh.p.k. Shoqëria \*\*\* informon se as shtetasit G dhe D.M, prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nuk kanë kontrata për shitblerjen e pasurive të paluajtshme me shoqërinë \*\*\* sh.p.k. Bashkëlidhet me kthim përgjigjen e shoqërisë \*\*\* sh.p.k. edhe informacioni si vijon për apartamentin dhe garazhin në përdorim nga subjekti i rivlerësimit. Këto pasuri gjenden në rrugën “\*\*\*\*”, ndërtuar me leje ndërtimi \*\*\* prot., datë 15.5.2005, për fazën e parë dhe leje ndërtimi nr. \*\*\*, datë 12.10.2008, për fazën e dytë.

**21.4 ASHK<sup>25</sup> Drejtoria Vendore Tirana Jug informon Komisionin se pasuria me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* është me leje ndërtimi nga shoqëria \*\*\* sh.p.k. dhe pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 17.82 m<sup>2</sup> është në pronësi të shtetasit S.B.I<sup>26</sup>.**

**21.5** Nga korrespondenca me operatorët e furnizimit me shërbime të ujësjellës kanalizime dhe energji elektrike nga hetimi, Komisionit i rezultojnë<sup>27</sup> se me gjeneralitetet S.I, referuar të dhënave të sistemit të faturimit në instancën Tiranë/\*\*\*\*, identifikohet një abonent me nr. \*\*. Ndërsa UKT-ja<sup>28</sup> informon se në emër të S.I rezultojnë

<sup>23</sup>Projekti i fundit që kemi qenë në bashkëpunim ka qenë ai i \*\*\* me adresë Blv. “\*\*\*\*”.

<sup>24</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2003, shoqëria \*\*\*.

<sup>25</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2020.

<sup>26</sup>Bashkëlidhet me përgjigjen, kontratë shitblerje për pasuri të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 5.12.2013, me palë blerëse S.I, palë shitëse shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. me administrator z. B.M me objekt shitjen e pasurive, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 112.9 m<sup>2</sup>, sipërfaqe shërbimesh 18.4 m<sup>2</sup> me adresë rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, apartamenti \*\*\*, në vlerën 110.000 euro; pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 17.82 m<sup>2</sup>, garazh në vlerën 10.000 euro.

<sup>27</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2022, e FSHU-së.

<sup>28</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2022, e UKT-së.

kontrata me nr. \*\*\* për objektin me adresë rruga “\*\*\*\*” Tiranë, në kategorinë e konsumatorëve familjarë.

**21.6** Bazuar në ligjin nr. 84/2016, neni 32 “Deklarimi i pasurisë”, pika 4 përcakton: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*. Në këtë këndvështrim, marrëdhënia e huapërdorjes ndërmjet shtetasit S.I dhe subjektit të rivlerësimit ka detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 4 të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Për sa është analizuar më sipër, Komisioni kreu hetimin në këndvështrim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 mbi këtë marrëdhënie dhe subjektet e saj dhe hetoi mbi mundësinë e krijimit me burime të ligjshme të pasurive “apartament dhe garazh” nga personi tjetër i lidhur i subjektit z. S.I, dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit.

**21.6.1** QKB-ja<sup>29</sup> ka përcjellë në Komision informacionin se për shtetasin S.I figurojnë të dhënat si në vijim:

- a) Administrator i shoqërisë \*\*\* sh.p.k., regjistruar me vendimin nr. \*\*\* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt të aktivitetit në fushën e ndërtimit dhe projektimit<sup>30</sup>.
- b) Administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. me NIPT \*\*\*, me objekt të aktivitetit tregtar në fushën e ndërtimit dhe projektimit, konsulencë juridike me kontraktorë të huaj. Përgatitje dhe vlerësim i dokumenteve të tenderave, me status aktiv<sup>31</sup>. Prej QKB online rezulton se kjo shoqëri është regjistruar në datën 24.2.1998 prej shtetasit A.T (100% të aksioneve) dhe në datën 3.4.2015 nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. \*\*\* i janë dhuruar 50% të aksioneve të saj shtetasit S.I, ndërsa në datën 29.6.2021 shtetasi S.I i ka dhuruar pjesën e tij të aksioneve në këtë shoqëri ortakut të vet, z. A.T.
- c) Me përgjigjen e QKB-së përcillet edhe ekstrakt i personit fizik “\*\*\*\*” me NIPT \*\*\* me emrin tregtar \*\*\*<sup>32</sup> me objekt të aktivitetit projektive, mbikëqyrje dhe kolaudim i punimeve të ndërtimit, shërbime konsulence në fushën e ndërtimit, planifikimit urban dhe peizazhit, me status aktiv.

**21.6.2** Nga dokumentacioni i përcjellë prej shoqërisë \*\*\*<sup>33</sup> sh.p.k. rezulton se pagesat për blerjen e apartamentit dhe garazhit në total janë në vlerën 119.842 lekë. Të ndara sipas viteve, pagesat e kryera janë në vitin 2010 vlera 36.000 euro, në vitin 2012 vlera 63.800 euro dhe në vitin 2013 vlera 20.42 euro, ndërsa nga kontratat e përcjella në Komision prej subjektit, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe praktikës së ASHK-së rezulton se vlera totale e blerjes së apartamentit dhe garazhit është 120.000 euro (110.000 euro +10.000 euro).

<sup>29</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2020, e QKB-së.

<sup>30</sup>Shihni faqen e parë paragrafi 2 të vendimit të gjykatës nr.\*\*\*, datë 6.11.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>31</sup>Sipas ekstraktit të QKB-së të përcjellë me shkresën data e regjistrimit është 18.2.1998 dhe S.I ka 50% të aksioneve në bashkëpronësi me shtetasin A.T.

<sup>32</sup>Sipas ekstraktit të QKB-së të përcjellë me shkresën data e regjistrimit është 1.1.2003.

<sup>33</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2022.

**21.6.3** Lidhur me burimin e ligjshëm të blerjes së apartamentit dhe garazhit prej personit tjetër të lidhur, shtetasit S.I, Komisioni analizoi të dhënat e konfirmuara nga DPT-ja<sup>34</sup> dhe QKB-ja<sup>35</sup> mbi fitimin e siguruar prej tij gjatë periudhës 2005 – 10.7.2013. Sa më lartshpjeguar, pagesat e apartamentit janë bërë nga mars 2010 deri në korrik të vitit 2013, ndërsa të ardhurat e personit tjetër në lidhur janë llogaritur nga aktiviteti i tij si person fizik, me NIPT \*\*\* për periudhën 2005 – 10.7.2013 sipas konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Edhe pse rezulton se personi tjetër i lidhur ka pasur aktivitet të regjistruar prej vitit 1998 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nga hetimi administrativ rezulton se nuk janë shpërndarë dividend gjatë ushtrimit të aktivitetit. Në vijim, Komisioni hartoi analizën financiare duke iu referuar vetëm të ardhurave personale të shtetasit S.I, të cilat mund të provoheshin nga viti 2005, si e ardhur nën NIPT \*\*\*, regjistruar si person fizik dhe nga paga e tij prej vitit 2012, të vërtetuara nga shkresa e ISSH-së<sup>36</sup>. Gjithashtu, janë llogaritur shpenzimet jetike për tre anëtarë për periudhën 2005 – 10.7.2013, mbështetur në numrin e anëtarëve të familjes sipas gjendjes civile të shtetasit S.I në këtë periudhë kohore.

**21.6.4** Ndërsa vihet re nga hetimi i Komisionit<sup>37</sup> se gjatë periudhës 2005 – korrik 2013 shtetasi S.I ose familjarët e tij nuk kanë kryer shitblerje në pasuri të paluajtshme ose të luajtshme.

**21.7** Komisioni, nga konsultimi me sistemin e arkivit dixhital të pasurive të paluajtshme IPS-së, konstatoi gjatë hetimit se shtetasi S.I rezulton pronar edhe në disa pasuri të tjera në qytetin e Tiranës. Gjithashtu, në kthim përgjigjen nga UKT-ja<sup>38</sup> sh.a. mbi abonentin S.I me këtë operator përcillen kontrata porosie apartamente të ndryshme në qytetin e Tiranës në pronësi të shtetasi SoS.I, si përfaqësues i studios “\*\*\*\*”. Sa më sipër, nga hetimi i Komisionit rezultoi se shtetasi S.I ka marrëdhënie kleringu mes shoqërive investitore, ndërtuese dhe atij si projektues në objekte të ndryshme edhe pse jo e shprehur me akt ligjor kontraktor marrëdhënia e “kleringut” mes shoqërive investitore dhe projektuesit.

**21.7.1** Gjithashtu, prej hetimit të llogarive bankare të tij, konstatohet se z. S.I ka likuiditete në llogaritë e tij bankare në vlera të konsiderueshme, të cilat datojnë prej vitit 1999. Nga \*\*\*<sup>39</sup> Bank (BIA bank) përcillet informacion se prej vitit 2000, shtetasi S.I ka depozita në llogaritë e tij vlerën 48.000 USD, ndërsa në vitin 2007 rezulton me depozita kursimi prej 111.228 euro, 6.649.618 lekë dhe 53.000 USD.

**21.8** Në vijim të shpjegimeve të mësipërme, Komisioni hartoi analizën financiare të personit tjetër të lidhur, z. S.I sipas së cilës rezultoi se personi tjetër i lidhur ka pasur mundësi të krijojë pasurinë me të ardhura të ligjshme pasuritë e dhëna në përdorim subjektiv të rivlerësimit, pasi totali i rezultatit të analizës financiare është 4.170.847 lekë.

## **Vlerësimi i Komisionit**

<sup>34</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2020, e DPT-së.

<sup>35</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2020, e QKB-së.

<sup>36</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2020, e ISSH-së.

<sup>37</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2020, e ASHK-së dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2022, e DPSHTRR-së.

<sup>38</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2022 kontrata me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>39</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2022.

Sipas parashikimeve të nenit 901 e vijues të Kodit Civil, marrëdhënia e huapërdorjes, përkufizohet si vijon: *“Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e palës që ka dhënë sendin”*.

Pronësia *de facto* e pasurive objekt vlerësimi, marrëdhënia e përdorimit të apartamentit të xhaxhait nga subjekti i rivlerësimit, përfshihet te marrëdhënia e huapërdorjes për shkak të qëndrueshmërisë së saj si marrëdhënie nga viti 2012, e në vijim, qetësisht, pa ndërprerje, nisur edhe nga rrethana e diktuar e padobishmërisë së përdorimit të këtij sendi nga pronari.

Në analizë të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi S.I konsiderohet person tjetër i lidhur dhe Komisioni, për të hequr çdo dyshim të mundshëm të arsyeshëm, hetoi mbi këtë pasuri në përdorim nga subjekti i rivlerësimit.

Në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin<sup>40</sup> D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet por jo vetëm, të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Tashmë është krijuar jurisprudenca në lidhje me faktin e provueshmërisë së subjekteve të rivlerësimit jo vetëm për dyfishin e pasurisë së ligjshme, por për çdo element kontrolli të pasurisë me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

Në vijim të shpjegimeve sa më sipër dhe në referencë të vendimit të Kolegjit<sup>41</sup>, në vlerësim logjik e të arsyeshëm tërësor të të gjitha rrethanave të hetuara nga Komisioni mbi këtë marrëdhënie huapërdorje, trupi gjykues vlerësoi se bazuar në të dhënat financiare të rezultuara nga hetimi shtetasi S.I ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme pasuritë, të dhënat reale të pronësisë së pasurive në përdorim, të deklaruara nga subjekti përputhen me të dhënat e rezultuara nga hetimi i Komisionit, lidhjen e afërt familjare me subjektin e rivlerësimit dhe pronarin e sendit të dhënë në përdorim, çmohet se deklarimi i subjektit në kuptim të procesit të rivlerësimit është në përputhje me dokumentacionin dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ. Nuk ka *indicie* për deklarim të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri dhe subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë dashur dhe nuk kanë pasur për qëllim ta fshehin pasurinë dhe marrëdhënien e huapërdorjes objekt verifikimi.

#### **A/1. Pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, bashkëshortja M.I, në deklaratën *Vetting***

**22. Automjet tip “SMART” me targa \*\*\***, blerë në vitin 2012 me kursime nga të ardhurat prej pagave në punë. Vlera: 3.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

<sup>40</sup>Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

<sup>41</sup> [http://kpa.al/\\*\\*\\*\)](http://kpa.al/***))

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*<sup>42</sup> dokumentacionin e fitimit dhe burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë automjet tip “SMART”, me targa \*\*\*. Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 automjetin tip “SMART 600cc”, kursime, vlera 3.000 euro.

### **Hetimi i kryer dhe verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri**

**22.1** DPSHTRR-ja<sup>43</sup> informon se shtetasja M.I ka të regjistruar automjetin me targa \*\*\*. Bashkëlidhet me shkresën praktika dhe dokumentacioni i regjistrimit të automjetit me targa \*\*\*. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur rezulton se me kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 31.5.2012, bashkëshortja e subjektit blen nga shtetasja E.K, automjetin Micro Compact Car \*\*\*, me ish targa \*\*\*, shasia \*\*\*, kundrejt çmimit 3.000 euro. Automjeti sipas deklaratës doganore konstatohet se është importuar nga shteti italian në datën 30.4.2012, në vlerën 500 euro + 121.367 lekë vlera e zhdoganimit me përshkrimin “\*\*\*\*”.

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se pasuria është krijuar me burim nga të ardhurat nga paga. Për të ardhurat nga paga në DIPP-në e vitit 2012 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar “paga neto si \*\*\* vlera 670 994 lekë”, llogari bankare në “Raiffeisen Bank”, vlera 118.000 lekë.

**22.2** “Raiffeisen Bank”<sup>44</sup> informon se shtetasja M.I ka llogari me nr. \*\*\*, me gjendje 675.821 lekë. Në datën e blerjes së automjetit (datë 31.5.2012) gjendja e llogarisë ka qenë 570.651 lekë me burim të ardhurat nga paga deri në janar 2010 dhe trajnimet ose konsulencat e kryera prej saj deri në këtë datë. Ndërsa “Credins Bank”<sup>45</sup> përcjell statement bankar, në të cilin janë transferuar të ardhurat nga paga të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej vitit 2010 e në vijim.

**22.3** ISSH-ja<sup>46</sup> informon se për shtetasen M.I janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore nga janari i vitit 2012 e në vijim nga Prokuroria e Përgjithshme. Komisioni hartoi analizën financiare për mundësinë për blerjen e automjetit me të ardhura nga paga sipas së cilës rezultati total financiar për periudhën viti 2011 deri më 31.5.2012 është në vlerën 491.476 lekë.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit në kuptim të procesit të rivlerësimit është në përputhje me dokumentacionin dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ. Nga hetimi, Komisionit i rezultoi se bashkëshortja e subjektit e ka krijuar këtë pasuri përpara fillimit të detyrës prej tij dhe ajo ka pasur mundësi të krijojë me të ardhurat e veta nga paga pasurinë. Subjekti e ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi pasurinë dhe nuk rezultuan problematika në kuptim

<sup>42</sup>Shihni aneks \*\*\* ILDKPKI. Kontratë shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 31.05.2012, me të cilin M.I blen nga shtetasja E.K, mjetin Micro Compact \*\*\* me ish targa \*\*\*, shasia \*\*\*, kundrejt çmimit 3.000 euro. Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2016, i Prokurorisë së Përgjithshme nga i cili rezulton se znj. M.M, me detyrë \*\*\* pranë Prokurorisë së Përgjithshme, për periudhën 1.9.2002 deri më 30.9.2016, ka realizuar të ardhura në total 9.158.225 lekë. Lëvizje llogarie e “Credins Bank” me nr. 199703, në emër të znj. M.I.

<sup>43</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2020, e DPSHTRR-së.

<sup>44</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2020.

<sup>45</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020.

<sup>46</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2020, nga ISSH-ja.

të pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**23. Llogari kursimesh në “Raiffeisen Bank” nga të ardhurat në vite. Vlera: 1.201.198 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” në emër të znj. M.I mbi lëvizjet në llogari për periudhën 18.10.2015 - 18.10.2016, ku gjendja e saj në këtë datë është 1.201.545 lekë.

**Hetimi i kryer dhe verifikimet e kryera nga Komisioni për këtë pasuri**

**23.1** “Raiffeisen Bank”<sup>47</sup> informon se shtetasja M.I ka llogari me nr.\*\*\*, me gjendje në vlerën 675.821 lekë. Nga *statement*-i i llogarisë rezulton se është hapur në datën 31.3.2005 dhe duket se është përdorur si llogari page e saj. Bashkëshortja e subjektit ka mbyllur si depozitë fleksi prej datës 5.2.2008 vlerën 100.627 lekë, e krijuar nga akumulimi i të ardhurave nga paga në këtë bankë. Prej datës së hapjes së depozitës vlera e saj është rritur nga transferimi i të ardhurave nga paga e bashkëshortes së subjektit, ku gjendja në datën 1.1.2017 ka qenë në vlerën 1.200.928 lekë. Kjo depozitë vazhdon të jetë aktive deri në ditën e kthimit të përgjigjes në Komision nga “Raiffeisen Bank”.

Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit, në kuptim të procesit të rivlerësimit, është në përputhje me dokumentacionin dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ.

**24. Llogari rrjedhëse e pagës me gjendje aktuale 128.940 lekë, në “Credins Bank”**

Bashkëshortja e subjektit, në lidhje me llogarinë e pagës në “Credins Bank”, ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2012 - 2016 vlerat 194.935 lekë, 351.846 lekë, 466.340 lekë, 472.422 lekë dhe 472.422 lekë.

“Credins Bank”<sup>48</sup> informon Komisionin se shtetasja M.I është kliente e kësaj banke dhe ka llogari rrjedhëse page me nr. \*\*\*, të hapur në datën 5.1.2010. Gjendja e llogarisë në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka qenë 128.940 lekë, e cila është krijuar nga kalimi i të ardhurave nga paga e bashkëshortes së subjektit.

Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit, në kuptim të procesit të rivlerësimit, është në përputhje me dokumentacionin dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ. Subjekti e ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi pasurinë dhe nuk rezultuan problematika, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**A/II. Gjatë hetimit nga Komisioni i deklarimeve të subjektit në DIPP-të periodike të viteve 2012 – 2016, rezultoi si vijon:**

**25. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratimet periodike të interesave private ndër vite, 2012 – 2016, para fillimit të detyrës, lidhur me detyrimet, ka deklaruar: “Kredi konsumatore në ‘Raiffeisen Bank’ marrë në datën 17.7.2009 deri në datën 17.7.2016, në vlerën 1.000.000 lekë, me këst mujor 21.692 lekë. Shuma e mbetur pa shlyer**

<sup>47</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2020.

<sup>48</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020.



730.000 lekë”. Në DIPP-të të viteve 2012 - 2016 subjekti ka deklaruar shlyerjen e kredisë<sup>49</sup>. “Raiffeisen Bank<sup>50</sup>” ka përcjellë në Komision shkresën, nëpërmjet të cilës konfirmohen vlerat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe shlyerja e kredisë prej 1.000.000 lekësh në datën 17.7.2016. Kjo kredi është përdorur për të mbyllur (vlera 634.263 lekë) një kredi të mëparshme konsumatore të marrë nga subjekti në datën 13.7.2006 me vlerë 200.000 lekë dhe pjesa e mbetur prej 365.650 lekësh është tërhequr prej tij në periudhën 22.7.2009 – 31.7.2009. Subjekti nuk ka detyrime kredie në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

### **A/III. Konstatime mbi deklarime të subjektit gjatë hetimit nga Komisioni**

**26.** Subjekti deklaroi<sup>51</sup> gjatë hetimit se ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale në tiroide në shkurt të vitit 2016, në spitalin \*\*\*, Tiranë, shpenzimet e së cilës janë paguar nga babai i tij B.I në shumën 2.500 euro me kartën e tij të kreditit. Komisioni administroi nga dosja e subjektit përgjigjen<sup>52</sup> e kthyer nga spitali \*\*\*, Tiranë, ku konfirmohet se vlera e shlyer për këtë ndërhyrje është 347.500 lekë. Ndërsa nga përgjigja e “Credins Bank”<sup>53</sup> konstatohet se në llogarinë e pagës së babait të subjektit të rivlerësimit rezulton se në datë 27.1.2016 është tërhequr vlera 150.000 lekë, në datën 8.2.2016 është tërhequr vlera 150.000 lekë dhe në datën 8.2.2016 është tërhequr vlera 300.000 lekë. Burimi i vlerave të tërhequra më lart (totali 600.000 lekë) janë pagat e babait të subjektit të transferuara nga Gjykata Kushtetuese. “Raiffeisen Bank<sup>54</sup>” konfirmon se në datën 12.2.2016 është kryer pagesa e shpenzimeve të spitalit me kartën e kreditit të z. B.I, në vlerën 2.500 euro, e cila është paguar nga derdhja *cash* prej 2.250 euro në datën 12.2.2016 dhe gjendjen e llogarisë në atë datë. Duket se tërheqjet e realizuara nga llogaria e z. B.I në “Credins Bank” gjatë periudhës 27.1.2016 – 12.2.2016 kanë shërbyer për shlyerjen e kartës së kreditit në “Raiffeisen Bank”.

**26.1** Komisioni analizoi mundësinë financiare për shlyerjen e vlerës së ndërhyrjes kirurgjikale prej 347.500 lekësh nga të ardhurat e familjes së babait të subjektit të rivlerësimit, të akumuluar gjatë periudhës 2015 – 31.1.2016, totali i rezultatit financiar të së cilës është në shumën 2.106.524 lekë.

**26.2** Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit, në kuptim të procesit të rivlerësimit, është në përputhje me dokumentacionin dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ. Nga hetimi rezultoi se familja prindërore e subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të shlyejë vlerën 347.500 lekë me të ardhurat e ligjshme të mbledhura gjatë periudhës 2015 - janar 2016.

---

<sup>49</sup>Në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar: “Kredi konsumatore në ‘Raiffeisen Bank’, shuma e shlyer nga deklarimi i parë 130.146 lekë, shuma e mbetur pa shlyer 657.517 lekë”; në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar: “Kredi konsumatore në ‘Raiffeisen Bank’ 100.000 lekë, gjenda e detyrimit e mbetur pa shlyer 523.543 lekë”; në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar: “Kredi konsumatore në ‘Raiffeisen Bank’ 100.000 lekë, gjenda e detyrimit e mbetur pa shlyer 348.468 lekë”; në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar: “Kredi konsumatore në ‘Raiffeisen Bank’ 100.000 lekë, gjenda e detyrimit e mbetur pa shlyer 348.468 lekë”; në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar: “Kredi konsumatore në ‘Raiffeisen Bank’ 1.000.000 lekë, gjendja e detyrimit e mbetur pa shlyer 138.322 lekë, shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm 210.146 lekë”; në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar: “Kredi konsumatore në ‘Raiffeisen Bank’ 1.000.000 lekë, shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm 138.322 lekë, shlyer detyrimi tërësisht në korrik 2016”.

<sup>50</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2020.

<sup>51</sup>Përgjigje nr. 4, pyetësori standard.

<sup>52</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.1.2018.

<sup>53</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020, e “Credins Bank”.

<sup>54</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2020, e “Raiffeisen Bank”.

## ANALIZA FINANCIARE QERSHOR 2012 – 2016

27. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruar në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike vjetore ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe detyrimet, nga përlllogaritja e tyre është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruar dhe/ose të kursyera, me të ardhurat nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2012, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i subjektit në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar, ka rezultuar me një bilanc të përgjithshëm në vlerë pozitive 4.207.662 lekë.

Pas njohjes me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit parashtrori shpjegimet e tij lidhur me një gabim material të kthim përgjigjes së “Raiffeisen Bank” të administruar gjatë hetimit të Komisionit, si vijon:

*“Lidhur me tabelën në të cilën pasqyrohet analiza financiare qershor 2012 – 2016, pavarësisht faktit se nuk më kërkohen shpjegime nga ana juaj, konstatoj disa pasaktësi të cilat, pasi u njoha me CD-në që përmban provat e administruara gjatë hetimit administrativ nga ana e Komisionit, provohet se janë bërë për shkak të një gabimi material në gjenerimin e të dhënave nga ana e ‘Raiffeisen Bank’.*

*Konkretisht, në këtë tabelë pasqyrohen tre kredi të marra nga ana e bashkëshortes, të cilat nuk janë marrë asnjëherë prej saj, si dhe të dhënat e pasqyruara në vërtetimin e lëshuar nga ana e bankës (përkatësisht vërtetimi i lëshuar me emër klienti: M M G dhe NRP klienti \*\*\*) nuk përputhen me të dhënat e llogarisë që bashkëshortja disponon në ‘Raiffeisen Bank’. Lidhur me këtë fakt ‘Raiffeisen Bank’, pas paraqitjes së bashkëshortes sime në drejtorinë juridike për të kërkuar shpjegime lidhur me këtë konstatim, ka konfirmuar verbalisht se ka një gabim prej tyre në gjenerimin e të dhënave, të cilat nuk i përkasin shtetasës M.I (M) dhe për të cilin kanë siguruar se do të njoftonin vetë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (bashkëlidhur do të gjeni dhe konfirmimin me email nga ana e bankës për marrjen e ankesës dhe fillimin e kryerjes së verifikimeve përkatëse, si dhe konfirmimin me email për rezultatin e verifikimit) ...pavarësisht faktit se nga ana juaj është konkluduar se rezultati i analizës financiare për periudhën qershor 2012 – 2016 rezulton në vlerë pozitive (dhe e tillë rezulton edhe nëse nuk do të konsiderohen në analizë kreditë e lartpërmendura) dhe nuk kam barra prove lidhur me këtë kriter, doja të sillja në vëmendjen tuaj faktin e lartpërmendur, me qëllim një pasqyrim sa më të saktë të të dhënave në tabelën përkatëse të analizës financiare”.*

Në përfundim të sa më sipër, bazuar në arsyetimet dhe qëndrimet e mbajtura nga subjekti i rivlerësimit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe

reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor, të cilat janë përcjellë pas njohjes me rezultatet e hetimit, si dhe analizoi qëndrimin e tij në seancën dëgjimore për rezultatin e analizës financiare, trupi gjykues arrin në konkluzionin se rezultati i analizës financiare të subjektit mbetet i pandryshuar në vlerë pozitive. Pas administrimit të dokumentacionit shoqërues me shpjegimet e subjektit pas njohjes me rezultatet e hetimit, analiza financiare vijon të jetë pozitive, por ndryshon vetëm vlera absolute e saj nga 4.207.662 lekë në 3.575.768 lekë. Kjo vjen pasi nuk janë përfshirë tre kreditë konsumatore në “Raiffeisen Bank” të bashkëshortes së subjektit, të cilat ishin në analizën financiare të rezultateve të hetimit (bashkëlidhur do të gjeni edhe analizën financiare).

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tj.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk janë të mjaftueshme që të sjellin zbatimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**28.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\*, datë 9.2.2021, të

deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2021, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**28.1** Gjithashtu, po sipas këtij raporti, Komisioni informohet se subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj ka qenë rezident në Itali gjatë periudhës gusht 2012 – dhjetor 2016<sup>55</sup>. Në vijim të hetimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni iu drejtua DSIK-së për përditësim të informacionit me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja, me shkresën nr. \*\*\*, datë 18.3.2021, informon se për subjektin e rivlerësimit nuk ka të dhëna dhe nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

### **Konkluzion për kriterin e kontrollit të figurës**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë ose i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**29.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përcjellë pranë Komisionit raportin<sup>56</sup> për vlerësimin e aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit dhe aktet bashkëlidhur tij. Në raportin e Komisionit të Vlerësimit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar nivele të mira në aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale dhe aftësitë personale dhe

<sup>55</sup>Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi se sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion bashkëlidhur raportit të analizimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, subjekti, mbështetur në VKM-në Nr. 523, datë 1.8.2003, “Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe të certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja”, Komisioni pranë Ministrisë së Arsimit, me urdhrin nr. \*\*\*, datë 22.2.2006, të Ministrisë dhe Shkencës, i ka njohur diplomimin në degën e drejtësisë, lëshuar nga Universiteti i \*\*\*, Itali, në datën 12.4.2005. Sa më sipër, duket se ky diplomim mund të jetë edhe arsyeja e pajisjes së subjektit të rivlerësimit me statusin e rezidentit në Itali.

<sup>56</sup>Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2021, ka përcjellë në Komision raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit dhe aktet bashkëlidhur tij. Ky raport është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.10.2021, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi” ka miratuar këtë raport të hollësishtë dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të z. Erjon Imeraj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

angazhimi profesional. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Erjon Imeraj, ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit të ushtrimit të detyrës ka punuar në fushën e të drejtës penale dhe procedurale penale si prokuror.

Ky raport është hartuar bazuar në: përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit; tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit<sup>57</sup>; pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënat nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të dhënat në Drejtorinë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**29.1** Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, si dhe të dhënave në Drejtorinë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj ka mbajtur funksionet, si vijon:

- Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 29.4.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, është emëruar oficer i policisë gjyqësore. Në periudhën maj 2005 – qershor 2012 ka ushtruar detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në Drejtorinë Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme.
- Me Dekretin nr. \*\*\*, datë 4.6.2012, të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë të cilën e ushtron deri aktualisht pranë kësaj prokurorie.

**29.2** Hetimi i Komisionit për këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni në këtë kuadër; (iii) kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i

---

<sup>57</sup>Subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj ka dorëzuar në Prokurorinë e Përgjithshme aktet, si vijon: formulari i vetëvlerësimit profesional, gjithsej 5 fletë; 11 dokumente shoqëruese të formularit të vetëvlerësimit, gjithsej 53 fletë. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si në vijim.

rivlerësimi<sup>58</sup>, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor<sup>59</sup>, si dhe të dhënave nga burimet arkivore<sup>60</sup> mbi të cilën është hartuar ky raport, trupi gjykues, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti i rivlerësimit ka analizuar rrezikshmërinë e autorit, rrezikshmërinë e veprës penale, si dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale në funksion të masës së dënimit të kërkuar. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar mbështetur në ligjin penal dhe atë procedural penal, si dhe ka argumentuar në mënyrë bindëse sa i përket vendimmarrjes mbi çështjet objekt verifikimi dhe vlerësimin nga Komisioni. Trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo elemente për të ngritur dyshime se subjekti ka një mënyrë/model pune të papajftueshëm me pozicionin e tij dhe as shkelje të respektimit të të drejtave të palëve.

Në vlerësimin e prokurorit Erjon Imeraj u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 8 denoncime. Komisioni, pasi administroi prapësimet e subjektit, të shoqëruara nga shpjegimet dhe provat përkatëse, si dhe pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e konstatuara në trajtimin e problematikave të ngritura në denoncimet e publikut. Nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla, që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

---

<sup>58</sup>Konkluzion përfundimtar për procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të pandehur P.R dhe E.B, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96, paragrafi 1 i Kodit Penal; konkluzion përfundimtar për procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të pandehur XH.M, akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje me dashje” dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar përkatësisht nga nenet 76 dhe 278, paragrafi 4 i Kodit Penal; konkluzion përfundimtar për procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të pandehur F.B dhe S.B, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 278, paragrafët 4 dhe 5 të Kodit Penal.

<sup>59</sup>Dosja 1 – kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 17.10.2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dokumenti ligjor, vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 14.11.2013, për kallëzimin penal nr. \*\*\* të vitit 2013; dosja 2 – dokumenti ligjor, vendim për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016, datë 25.5.2016, regjistruar në datën 25.2.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dosja 3 – dokumenti ligjor vendim “Për pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2014”, datë 6.5.2014. Procedimi penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 6.2.2014, për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236, paragrafi 1 i Kodit Penal; dosja 4 – dokumenti ligjor, kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015”, datë 27.4.2015. Procedimi penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 28.1.2015, për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, parashikuar përkatësisht nga neni 137, paragrafi 1 i Kodit Penal; dosja 5 – dokumenti ligjor, kërkesë “Për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*”, datë 29.9.2015. Procedimi penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 8.6.2015, në ngarkim të shtetasit F.A, akuzuar për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134, paragrafi 1 i Kodit Penal.

<sup>60</sup>Praktika nr. \*\*\* prot., e vitit 2013, ka të bëjë me ankesën e shtetasit I.L.L drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit Erjon Imeraj; praktika nr. \*\*\* prot., e vitit 2018, ka të bëjë me ankesën e shtetasit E.K drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit Erjon Imeraj; praktika nr. \*\*\* prot., e vitit 2018, ka të bëjë me ankesën e shtetasit S.SH drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit Erjon Imeraj; praktika nr. \*\*\* prot., e vitit 2018, ka të bëjë me ankesën e shtetasit H.H, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit Erjon Imeraj; praktika nr. \*\*\* prot., e vitit 2017, ka të bëjë me ankesën e shtetasit R.XH drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit Erjon Imeraj; praktika nr. \*\*\* prot., e vitit 2017, ka të bëjë me ankesën e shtetasit H.SH drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit Erjon Imeraj; praktika nr.\*\*\* prot., e vitit 2018, ka të bëjë me ankesën e shtetasit H.SH, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit Erjon Imeraj; praktika nr. \*\*\* prot., e vitit 2017, ka të bëjë me ankesën e shtetasit N.L drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit Erjon Imeraj; praktika nr. \*\*\*prot., e vitit 2018, ka të bëjë me ankesën e shtetasit H.H drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, kundër prokurorit Erjon Imeraj. Ankesat janë marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Studimeve, Inspektimit dhe Çështjeve të tjera Ligjore, në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës të Shqipërisë dhe ju janë shpjeguar shkresërisht nga Prokuroria e Përgjithshme se organi i vetëm kompetent për të vlerësuar vendimmarrjen e prokurorisë është gjykata, në këto kushte i është sugjeruar që për pretendimet e paraqitura duhet t’i drejtohet gjykatës pranë së cilës prokurori ushtron funksionin. Për sa ka pretenduar, për faktet abuzive me detyrën e prokurorëve të çështjes, janë orientuar ankesit për të paraqitur kallëzim penal sipas nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale.

<sup>60</sup>Shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.6.20211, e Prokurorisë së Përgjithshme.

Komisioni ka hetuar denoncimet duke vlerësuar edhe aktet përkatëse të përgatitura nga prokurori, si dhe në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, për të cilat nuk u gjenden të dhëna të cilat mund të merren në konsideratë në vlerësimin e aftësive profesionale.

Prokurori e ka bërë cilësimin ligjor referuar akteve të dosjeve penale dhe pretendimeve të palëve dhe të drejtës së ushtrimit nga ana e tij të ndjekjes penale.

Trupi gjykues vlerëson të theksojë se, pavarësisht se në një kallëzim penal tregohet një fakt dhe kryhet një cilësim ligjor penal i faktit të pretenduar, është prokurori ai i cili pasi kryen një hetim të plotë të ngjarjes, bën cilësimin e saktë ligjor nga pikëpamja e së drejtës penale. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, në kuptim të nenit E, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të vijë ndesh me dispozitat procedurale që parashikohen në nenet 24, 327/2 dhe 221 të Kodit të Procedurës Penale. Detyrimi i Komisionit është të verifikojë nëse organi i akuzës ka zhvilluar hetime të plota dhe të gjithanshme. Ndërkohë, referuar vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, të cilat kanë verifikuar ligjshmërinë e veprimeve të subjektit të rivlerësimit në ushtrim të funksionit të tij kushtetues si prokuror, nuk rezulton mosmarrje parasysh të kërkesave për kryerje të veprimeve hetimore apo tregohen veprime hetimore që sipas ligjit duhet të ishin bërë, por nuk ishin kryer, të cilat do të vlerësoheshin si të domosdoshme për arritjen e një konkluzioni të drejtë, në kuptim të pikës 3, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, të cilat do të vlerësoheshin nga Komisioni si aftësi profesionale.

### **Rivlerësimi i aftësive profesionale sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”**

Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias<sup>61</sup> dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>62</sup>, të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se nuk ka problematika të evidentuara dhe shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit pa gjykuar dinamikën e procedimeve lidhur me veprimet hetimore dhe ndjekjen penale, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e udhëheqjes së veprimeve hetimore në procedimet penale. Pavarësisht sa më sipër, në raport me të gjitha çështjet e analizuara, rezultoi se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit sistemit të drejtësisë penal si pjesë e sistemit të drejtësisë penale dhe në kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale hetimore. Zotëron njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, referuar ligjit

<sup>61</sup>Shihni opinionin nr. \*\*\*, të Venecias. Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>62</sup>Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në asnjë rast subjekti i rivlerësimit nuk është bërë shkak me veprimet apo mosveprimet e tij për tejkalimet e afateve të hetimit dhe nuk u vërtetua që këto tejkalime të kenë qenë të qëllimshme, por kanë ardhur për shkaqe të pavarura prej tij, si dhe për shkak të kompleksitetit të çështjeve, rrethanë e cila vlerësohet proporcionalisht në raport edhe me treguesit e tjerë brenda kriterit të aftësive organizative, sikurse ngarkesa në punë. Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatorit të çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte, trupi gjykues, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLP-ja, si dhe me denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Erjon Imeraj ka arritur një nivel kualifikues me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

Në përfundim, në zbatim të pikës 1, të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se subjekti i rivlerësimit:

- a) ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- b) ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- c) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016;
- ç) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatorit të çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar i aftë profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit z.Erjon Imeraj ka plotësuar së bashku kushtet, si vijon:



- a. Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z.Erjon Imeraj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 14.10.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Suela ZHEGU**  
**Kryesuese**

**Roland ILIA**  
**Relator**

**Etlida ÇIFTJA**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Albana Plaka*

## ANEKS 1 – ANALIZA FINANCIARE QERSHOR 2012 – 2016

<i>Përshkrimi</i>	<b>6.6.2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>PASURI</b>	<b>514 099</b>	<b>-198 666</b>	<b>322 120</b>	<b>-115 123</b>	<b>-14 022</b>
Automjet Mercedes Benz targa ****, Blerë në vitin 2010 me të ardhura nga puna në vite. Vlera 700,000 lekë.					
Automjet tip Smart, me targa **** në pronësi të bashkëshortes. Blerë në vitin 2012 (kontratë dt. 31.05.2012) me kursime nga të ardhurat prej pagave në punë. Vlera 3000 euro					
Shtesa/pakesime likuiditete	514 099	- 198 666	322 120	- 115 123	- 14 022
<i>Total likuiditete</i>	2 066 444	1 867 778	2 189 898	2 074 775	2 060 753
<b>DETYRIME</b>	<b>-71 276</b>	<b>-143 716</b>	<b>-176 213</b>	<b>-210 146</b>	<b>-138 323</b>
Kredi konsumatore në Raiffeisen bank marrë në datë 17.07.2016 në vlerë 1.000.000 lekë prej subjektit	-71 276	-143 716	-176 213	-210 146	-138 323
Kredi konsumatore në Raiffeisen bank marrë në datë 11.12.2013 në vlerë 76.000 lekë, prej bashkëshortes					
Kredi konsumatore në Raiffeisen bank marrë në datë 18.06.2014 në vlerë 300.000 lekë, prej bashkëshortes					
Kredi konsumatore në Raiffeisen bank marrë në datë 15.07.2016 në vlerë 700.000 lekë, prej bashkëshortes					
<b>PASURI NETO</b>	<b>585 375</b>	<b>-54 950</b>	<b>498 333</b>	<b>95 023</b>	<b>124 300</b>
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>1 532 259</b>	<b>1 501 185</b>	<b>2 024 991</b>	<b>2 019 398</b>	<b>2 026 929</b>
Të ardhura nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme (maj 2005-qershor 2012)					
Të ardhura nga mësimdhënia pranë Universitetit ***, vitet 2010-2014 (derdhur pranë Union Bank).	4 050	14 850	29 250		
Të ardhura nga paga si Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (qershor 2012 e në vijim)	481 866	834 893	1 051 366	1 040 030	1 039 567
Të ardhura të bashkëshortes nga paga si oficer i policisë gjyqësore pranë Drejt. së Marrëdhënieve me ***në Prokurorinë e Përgjith. për periudhën (shtator 2002-dhjetor 2016)	388 144	213 847	944 375	976 312	987 362
Të ardhura nga bashkëpunimi teknik me fondacionin ****, mars 2014 (derdhur në Credins bank)					
Të ardhura nga mësimdhënia si pedagoge e jashtme pranë **** në U.T. vitet 2008-2012.					
Të ardhura nga ISSH-ë për barrë lindje		420 203			
Dieta për dy vizita studimore jashtë shteti, përkatësisht në Francë dhe Mbretëri të Bashkuar të dhëna nga ****.					
Të ardhura nga interesat e depozitës së bashkëshortes		17 392		3 056	
Të ardhura të bashkëshortes para martese	37 500				
Të ardhura nga paga e prindërve (qershor-shtator 2012)	620 699				
<b>SHPENZIME</b>	<b>705 508</b>	<b>706 001</b>	<b>919 478</b>	<b>973 839</b>	<b>911 401</b>
Shpenzime interesi për kredinë pranë Raiffeisen Bank, kredia 700,000 leke					
Shpenzime interesi për kredinë pranë Raiffeisen Bank, kredia 300,000 leke					
Shpenzime interesi për kredinë pranë Raiffeisen Bank, kredia 76,000 leke					
Shpenzime interesi për kredinë pranë Raiffeisen Bank	69 809	115 020	77 560	39 476	7 078
Shpenzime për mobilimin	75 000				
Shpenzime për shkollimin e djalit					50 000
Shpenzime jetese	188 032	399 568	659 994	672 828	705 276
Shpenzime udhëtimi	372 667	191 414	181 924	261 535	149 048
<b>Analiza e dokumentuar</b>	<b>241 375</b>	<b>850 133</b>	<b>607 180</b>	<b>950 536</b>	<b>991 227</b>